

# BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË  
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",  
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1  
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445  
Mobile: (0)68 20 67 630  
E-mail: [info@qkzh.org](mailto:info@qkzh.org)

[www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)

Rezultatet e vrojimit të  
biznesit dhe konsumatorëve  
Nr. 22, Dhjetor 2006



*Business and Consumer  
Survey Results  
No 22, December 2006*


## INDUSTRIA PËRPUNUESE

## MANUFACTURING SECTOR

Klima e biznesit në sektorin e industrisë përpunuese do të jetë pozitive edhe për 3 mujorin e katërt të këtij viti. Treguesi i besueshmërisë në këtë sektor rritet për të tretin 3-mujor radhazi, duke shënuar një përmirësim edhe në krahasim me një vit më parë. Faktorët kryesorë që kanë çuar në rritjen e besueshmërisë dhe për rrjedhojë në përmirësimin e klimës së biznesit, janë përmirësimi i nivelit të kontraktimeve dhe ulja e nivelit të stokut të produkteve të gatshme, si rrjedhojë e rritjes së volumit të shitjeve të këtij sektori. Po kështu klima e biznesit është përmirësuar edhe nga përmirësimi i furnizimit me energji elektrike, përmirësimin të infrastrukturës dhe uljes së ndikimit negativ të korrupsionit të organeve tatimore. Faktorët pengues më të ndjeshëm në muajin tetor janë legjislacioni financiar, konkurrenca e pandershme nga tregu i zi, si dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar. Investimet për vitin 2007 parashikohet të shkojnë në shumë për futjen e teknologjive të reja, si dhe mekanizimin apo modernizimin e linjave ekzistuese, ndërsa më pak investime parashikohen të kryhen për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, qoftë edhe duke ndryshuar gamën e produkteve.

**Treguesi i besueshmërisë**, në sektorin e industrisë përpunuese në muajin tetor vazhdon rritjen e

FIGURA 1 Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

dy tremujorëve të kaluar, duke arritur nivelin e 11 pikëve. Ky nivel është jo vetëm 3 pikë më i lartë se 3 muaj më parë (shiko figurën 1), por edhe 3 pikë më shumë se një vit më parë. Nisur nga përbërësit e këtij treguesi, shikohet se përmirësimi i treguesit të besueshmërisë në muajin tetor 2006 ka ardhur veçanërisht nga rënia e ndjeshme e niveleve të gjendjes së produkteve të gatshme, si dhe nga një qëndrueshmëri në nivelin e kontraktimeve apo porosive për këtë sektor. Parashikimi i aktivitetit të prodhimit është në shkallë zbritëse duke ndikuar jo pozitivisht në përmirësimin e treguesit të QKZH-së për besueshmërinë.

### Klima e biznesit sipas nëndegëve të industrisë përpunuese

Treguesi i QKZH-se për besueshmërinë në industrinë e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve ka një përmirësim të dukshëm me 18 pikë në përqindje në krahasim me tre muajt më parë duke parashikuar në këtë mënyrë zhvillime pozitive për këtë nëndegë. Në industrinë ushqimore, pijeve dhe duhanit megjithëse treguesi i besueshmërisë qëndron në nivele pozitive, krahasuar me tremujorin e fundit, ka një rënie prej 10 pikësh në përqindje. Balanca në përqindje e këtij treguesi për industrinë e fabrikimit të artikujve prej druri, mobililjeve, etj ka një qëndrueshmëri në vlera për dy tremujorë të njëpasnjëshëm (shiko figurën 2).

Tendencë në rritje të treguesit të besueshmërisë, shënon industria e metalurgjisë, punimit të metaleve, fabrikimit të makinave, pajisjeve dhe pjesëve të ndërrimit, i pajisjeve elektrike etj, me 14 pikë në përqindje më shumë se tremujori i fundit duke kaluar në nivele pozitive vlerësimi. Industria e letres, kartonit, botimeve, kimike, kauçukut dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi ka një tendencë rënieje të treguesit të besueshmërisë nga niveli pozitiv i 20 pikëve për tremujorin e kaluar në nivelin negativ të 4 pikëve. Treguesi i besueshmërisë për fabrikimin e artikujve minerale jo metalike vazhdon të ruaje nivele negative dhe për tremujorin e katërt të 2006.

### Parashikimi i aktivitetit të prodhimit

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e prodhimit në 3 muajt e ardhshëm është pozitive me 18 pikë. Ky nivel tregon për një tendencë rritjeje të këtij sektori edhe në 3 mujorin e katërt, por kjo rritje do të jetë me ritme më të ulëta se në 3 mujorin e tretë të vitit 2006, pasi balanca e përgjigjeve për këtë pyetje ka ardhur në shkallë zbritëse (shiko figurën 4). Po kështu, ky nivel është më i ulët se mesatarja e balancës së përgjigjeve të dhëna gjatë periudhës 2002-2005 me 6 pikë në përqindje.

### Niveli i kontraktimeve

Niveli i kontraktimeve në muajin tetor 2006 është një pikë i përmirësuar në krahasim me 3 mujorin e kaluar, si dhe 5 pikë në krahasim me një vit më parë (shiko figurën 5). Ky tregues në bazë të anketimit të fundit ka një rritje me 4 pikë në përqindje nga mesatarja tre vjecare. Përmirësimi në nivelin e kontraktimeve në sektorin e industrisë përpunuese jep një garanci për një qëndrueshmëri të aktivitetit prodhues për këtë sektor edhe në 3 mujorin e katërt.

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 3: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing branches






FIGURA 4: Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese  
Expectation of business activity in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 5: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë përpunuese  
Assesment of order-books in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

### Gjendja e produkteve të gatshme

Treguesi i nivelit të gjëndjes së produkteve të gatshme (stokut) në muajin tetor ka pësuar një ulje të ndjeshme prej rreth 19 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë dhe prej rreth 17 pikësh në krahasim me muajin tetor 2005. Përmirësimi i niveleve të gjëndjes së produkteve të gatshme ka qenë edhe faktori kryesor në rritjen e treguesit të besueshmërisë së këtij sektori. Ndikimi i këtij faktori në besueshmëri ka të bëjë kryesisht me rritjen e volumit të shitjeve të produkteve të gatshme të këtij sektori dhe për rrjedhojë në përmirësimin e situatës financiare të firmave të industrisë përpunuese.

### Aktiviteti i prodhimit në 3muajt e kaluar


Balanca e përgjigjeve në lidhje me vlerësimin e aktivitetit të prodhimit në 3 muajt e mëparshëm, në muajin tetor 2006 arrin nivelin më të lartë të 3 vjetëve të fundit me 25 pikë. Ky nivel është 9 pikë më i lartë se 3 muaj më parë dhe 15 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë. Ky nivel konfirmon treguesin e besueshmërisë në këtë sektor, i cili ka një përmirësim prej 3 tremujorësh të njëpasnjëshëm. Siç shikohet nga figura 7 tremujori i tretë i vitit 2006 duhet të jetë nivelin më i lartë i prodhimit në industrinë përpunuese në këto tre vjet.

### Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese

Vlerësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në muajin tetor shikohet se është në nivelin prej 65%. Ky nivel është 4% më i ulët se 3 muaj më parë, por i njëjtë me treguesit e dy tremujorëve të parë të këtij viti. Tendanca e konsolidimit të nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese pas janarit të vitit 2005 në nivelet 65-70%, tregon për një qëndrueshmëri në nivelin e volumit të kontraktiveve, por që përbën një sinjal jo shumë nxitës për rritjen e investimeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve prodhuese në sektorin e industrisë përpunuese, pasi mesatarisht mbeten pa u shfrytëzuar rreth 35% të kapaciteteve ekzistuese prodhuese. Në vendet e tjera me një sektor të industrisë prodhuese dinamike, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese është në nivele 75-90%. Megjithatë, nga figura 8 shikohet qartë se në dy vjetët e fundit kapacitetet prodhuese në këtë sektor kanë një rritje 10-15 për qind në krahasim me periudhën 2002-2004.


**Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese** në industrinë e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve ka vlerën aktuale më të lartë me 79% si dhe vlerën maksimale më të lartë për të gjithë periudhën e anketimit. Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit dhe për këtë tremujor shënon vlerën aktuale më të ulët me 50%.

FIGURA 6: Vlerësimi i produkteve të gatshme në industrinë përpunuese  
Assesment of stocks in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar  
Assesment of production activity in manufacturing the last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese  
Capacity utilisation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese sipas degëve të industrisë përpunuese, 2002-2006  
Capacity utilisation in manufacturing branches 2002-2006




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstileve dhe lëkurë këpucëve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

**FIGURA 10: Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese**  
**Assessment of production capacity in manufacturing sector**




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 11: Parashikimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese**  
**Assessment of selling prices in manufacturing sector**




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 12: Parashikimi i punësimit në industrinë përpunuese**  
**Employment expectations in manufacturing sector**



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 13: Parashikimi i kontratave për eksport në industrinë përpunuese**  
**Export expectation in manufacturing sector**



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese**

Balanca e përgjigjeve nëse kapacitetet prodhuese në industrinë përpunuese janë apo jo të majftueshme është shumë afër vlerës neutrale me 1 pikë (figura 10). Ky nivel garanton se kapacitetet prodhuese në këtë industri janë të majftueshme, nuk përbën rrezik për rritjen e çmimeve të produkteve për të përcjellë një rritje eventuale të nivelit të kontraktimeve. Por nga ana tjetër ato nuk flasin për një nevojë reale për rritjen e investimeve në këtë sektor për rritjen e kapaciteteve ekzistuese.

**Çmimet e shitjes**

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e çmimeve të produkteve industriale ka një tendencë të lehtë rritjeje, prej 4 pikësh në karahasim me 3 muaj më parë, por qëndron në të njëjtin nivel si ai në muajin tetor 2006. Tendeca për një rritje të vogël të çmimeve të produkteve industriale nuk mund të interpretohet si një ndikim i faktorëve makroekonomike, por nga një përmirësim në rritje të niveleve të kontraktimeve që çon në mënyrë të natyrshme në një tendencë rritjeje të çmimeve të prodhimit. Megjithatë nga ecuria e grafikut të çmimeve të prodhimit vërejmë se çmimet e prodhimeve do të kenë pak ose aspak ndikim në nivelin e çmimeve me pakicë.


**Parashikimi i punësimit**

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e punësimit në 3 muajt e ardhshëm, në muajin tetor 2006 është pozitive prej 11 pikësh, por ky nivel është 7 pikë më i ulët se 3 muaj më parë, si dhe 11 pikë më pak se në tetor të vitit 2005. Ky nivel në parashikimin e punësimit në këtë sektor flet për një prirje të lehtë të rritjes së niveleve aktuale të punësimit, por me ritme relativisht më të ulta se në dy tremujorët e parë të këtij viti.

**Parashikimi i kontratave për eksport**

Figura 13 paraqet vlerësimet për përgjigjet në lidhje me parashikimin e kontraktimeve për eksport. Parashikimet e nivelit të kontraktimeve për eksport paraqiten me luhataje të theksuara nga një tremujor në tjetrin, gjë që flet se ecuria e eksporteve për këtë sektor është akoma e paqëndrueshme, megjithëse shikohen disa tendenca në stabilizim të nivelit të kontraktimeve në dy tremujorët e fundit. Si përfundim mund të thuhet se megjithëse parashikimet e nivelit të kontraktimeve janë pozitive, përsëri nuk mund të thuhet se kontraktimet e eksporteve janë në nivele të tilla që garantojnë një qëndrueshmëri dhe rritje në sektorin e industrisë përpunuese.

FIGURA 14: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar  
Assesment of order-books in manufacture last 3 months



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


**Niveli i kontraktiveve në 3 muajt e kaluar**

Treguesi i vlerësimit të nivelit të kontraktiveve për 3 muajt e kaluar, në muajin tetor tregon përsëri që diferenca e përgjigjeve në përqindje për nivelin e mjaftueshmërisë është 23 pikë, me vetëm 2 pikë më pak se një 3 mujor me parë, por rreth 21 pikë më shumë se një vit më parë. Kjo tendencë pozitive në nivelin e kontraktiveve konfirmon faktin se niveli i kontraktiveve në këtë sektor po bëhet solide gjithë që jep garanci të mjaftueshme për një rritje të mëtejshme të sektorit të prodhimit.

**Struktura e investimeve**

Figura 16 tregon ndryshimet e strukturës së investimeve që kanë kryer firmat e intervistuar në muajin tetor të viteve 2003-2006 në lidhje me parashikimin e investimeve për vitin e ardhshëm. Siç shikohet nga figura kemi një tendencë të qartë në rënie të investimeve për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese pa ndryshuar gamën e produkteve. Në vitin 2003 janë deklaruar se 23% e të intervistuarve do të kryenin investime në këtë drejtim, ndërsa në tetor 2006 vetëm 4% e të intervistuarve theksojnë se do të zgjerojnë këto kapacitete pa ndryshuar gamën e prodhimeve. Edhe në rastin kur zgjerimi i kapaciteteve prodhuese do të çojë në rritjen e gamës së produkteve struktura e investimeve duket se ka një rënie në krahasim me investime e tjera. Për vitin 2007 drejtimi

FIGURA 15: Vlerësimi i nivelit të prodhimit në muajt në industrinë përpunuese  
Assesment of months of production in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**Garancia në muajt e nivelit të prodhimit**

Treguesi i garancisë së nivelit të prodhimit në sektorin e industrisë përpunuese tregon vlerën prej 9.5 muaj. Ky nivel është 0.5 muaj më poshtë se ai i treguar 3 muaj më parë, por përgjithësisht ruan nivelin mesatar të këtij treguesi, që nga prilli i vitit 2005. Siç shikohet nga figura 15 niveli i garancisë në muajt e nivelit të prodhimit në dy vitet e fundit është përmirësuar me rreth 1.5 muaj e krahasuar kjo me vitet 2003-2005.

kryesor i investimeve në sektorin e industrisë përpunuese do të drejtohet në futjen e teknologjive të reja prodhuese. Në këtë drejtim kanë deklaruar në tetor të vitit 2006, 35% e të anketuarve, e cila është edhe përqindja më e lartë. Po kështu rritje parashikohet të ketë në strukturën e investimeve që parashikohet për mekanizimin dhe automatizimin e proceseve ekzistuese në sektorin e industrisë përpunuese. Përqindja e të intervistuarëve që deklarojnë këtë lloj investimi rritet nga 14% në vitin 2003 në 24% në vitin 2006. Një zhvillim tjetër interesant në strukturën e investimeve për këtë sektor është një rritje e investimeve që çojnë në kursimin e energjisë elektrike, kontrollin e ndotjeve amjentale si dhe masat mbrojtëse në punë.

Figura 16: Parashikimi i investimeve për vitin e ardhshëm




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

## Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese Constraints within manufacturing sector


Në muajin tetor 2006 *keq-zbatimi apo keq hartimi i legjislacionit fiskal* duket se po bëhet faktori me problematik për biznesin në sektorin e industrisë përpunuese. Këtë faktor e kanë cilësuar 36% e të anketuarve, nivel i cili është 7 pikë në përqindje më i lartë se 3 muaj më parë. Industria e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve ka vlerën aktuale më të lartë të kësaj pengese me 47% (figura 20). *Konkurrenca e pandershme nga tregu informal* është faktori i dytë më kufizues në këtë sektor. Këtë faktor e për

mendin 36% e të anketuarëve, nivel i cili është 2 pikë më i ulët se 3 muaj më parë, dhe rreth 9 pikë më i ulët nga niveli mesatar i shënuar në dy vitet e fundit. Ndikimi i *kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i brendshëm* duket se ka shënuar një ulje të lehtë. Në tetor është rregjistruar vetëm 27% e të anketuarve, kundrejt 34% që ishte 3 muaj më parë. Vlerën aktuale më të lartë për mungesën e kërkesës nga tregu i brendshëm e ka industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit me 57%.


**FIGURA 17: Ndikimi i tregut informal në industrinë përpunuese**  
*The impact of informal sector in manufacturing sector*




**FIGURA 18: Ndikimi i tregut informal sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of informal sector in manufacturing branches*




**FIGURA 19: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal në industrinë përpunuese**  
*The impact of fiscal legislation in manufacturing sector*




**FIGURA 20: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of fiscal legislation in manufacturing branches*



**FIGURA 21: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brënda vendit**  
*Insufficient domestic demand in manufacturing sector*




**FIGURA 22: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brënda vendit sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*Insufficient domestic demand in manufacturing branches*



Përmirësimet në furnizimet me **energji elektrike** për firmat prodhuese duket se kanë vazhduar edhe në tremujorin e 3-të të këtij viti. Tashmë për këtë faktor kufizues janë shprehur vetëm 20% e të anketuarve, i cili jo vetëm që është niveli më i ulët i regjistruar që nga janari i vitit 2002, por ka një ulje të ndjeshme po të krahasohet me tetorin e vitit 2005, për të cilin janë shprehur 74% e të anketuarve. Sipas një analize të nëndegëve të industrisë përpunuese në tetor 2006 kjo pengesë shënon vlerën minimale në industrinë e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike. **Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar** duket se po bëhet një shqetësim konstant për


biznesin në sektorin e industrisë përpunuese. Për këtë faktor në mënyrë konsistente e kanë përmendur 25-33% e të anketuarëve. Në muajin tetor 2006 këtë faktor e kanë përmendur 27% e të anketuarve, me një rritje prej 3% në krahasim me 3 muaj më parë. **Konkurrenca nga importet** në anketimin e tetorit 2006 ka shënuar vlerën në përqindje prej 20%. Në krahasim me tre muaj më parë kemi një rënie prej 4 % ndërsa krahasuar me një vit më parë kjo rënie është me 6 %. Industria e tekstilëve dhe lëkurë këpucëve ka vlerën maksimale më të lartë krahasuar me nëndegët e tjera të industrisë përpunuese me 31%.

FIGURA 23: Ndikimi i mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar në industrinë përpunuese  
*The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 25: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike në industrinë përpunuese  
*The impact of shortages on electricity in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 27: Konkurrenca nga importet në sektorin e industrisë përpunuese  
*Competitive imports in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 24: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar sipas degëve të industrisë përpunuese  
*The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing branches*




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lëkurë këpucëve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

FIGURA 26: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike sipas degëve të industrisë përpunuese  
*The impact of shortage on electricity in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lëkurë këpucëve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek


FIGURA 28: Konkurrenca nga importet sipas degëve të industrisë përpunuese  
*Competitive imports in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lëkurë këpucëve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

Ndikimin e **kërkesës së pamjaftueshme** nga tregu i jashtëm në muajin tetor e përmendin 17% e të anketuarëve, nivel ky 4 % më i lartë se 3 muaj më parë, por që mbetet i njëjtë po të krahasohet me nivelin e regjistruar një vit më parë. **Ndikimi i mungesës së infrastrukturës** mbi sektorin industrial duket se po zvoglohet. Kjo tendencë vërehet veçanërisht në 3 anketimet e fundit të vitit 2006. Në tetor 2006 këtë faktor pengues e kanë cilësuar 14% e të anketuarëve, me një rënie prej 5 % në përqindje në krahasim me 3 muaj më parë, dhe 25% më pak se një vit më parë.


FIGURA 29: **Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm**  
*Insufficient foreign demand in manufacturing sector*



Burimi: Qendra për Kerkim dhe Zhvillim, Tiranë


**Vështirësitë financiare** si faktor kufizues në muajin tetor 2006, arrijnë nivelin më të ulët të regjistruar që nga janari i vitit 2002 me 12% e të anketuarëve, nivel i cili është 2 pikë më i ulët se 3 muaj më parë, dhe 14 pikë më i ulët se një vit më parë. Në përmirësimin e gjendjes financiare të firmave në sektorin e industrisë përpunuese një rol ka luajtur stabiliteti në rritje të nivelit të kontraktimeve dhe ulja e ndjeshme e nivelit të stokut të produkteve të gatshme, e cila reflekton një nivel në rritje të shitjeve të produkteve të gatshme në këtë sektor.

FIGURA 30: **Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of Insufficient foreign demand in manufacturing branches*




15-16 Industria ushqimore, epijeve dhe duhanit  
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobililjeve  
21-25 industria e letres, plastikës, rafinimi i naftës  
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

FIGURA 31: **Ndikimi i mungesës së infrastrukturës në sektorin e industrisë përpunuese**  
*The impact of lack of infrastructure in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kerkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 32: **Ndikimi i mungesës së infrastrukturës sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of lack of infrastructure in manufacturing branches*




15-16 Industria ushqimore, epijeve dhe duhanit  
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobililjeve  
21-25 industria e letres, plastikës, rafinimi i naftës  
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve

FIGURA 33: **Vështirësitë financiare në sektorin e industrisë përpunuese**  
*Financial constrains in manufacturing sector*



Burimi: Qendra për Kerkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 34: **Vështirësitë financiare në industrinë e prodhimit sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*Financial constrains in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, epijeve dhe duhanit  
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobililjeve  
21-25 industria e letres, plastikës, rafinimi i naftës  
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

## SEKTORI I NDERTIMIT

## CONSTRUCTION SECTOR

### Klima e biznesit

Klima e biznesit në sektorin e ndërtimit është duke u përmirësuar. Treguesi i besueshmërisë në muajin tetor është 4 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë. Vlerësimet tregojnë se biznesi në ndërtim në 3 muajorin e tretë dhe veçanërisht në 3 muajorin e fundit të këtij viti do të vijë duke u përmirësuar, si rezultat i rritjes së nivelit të kontraktimeve dhe në mënyrë të veçantë nga ulja e ndikimit të faktorëve negative në ndërtim, si informaliteti, përmirësimet e infrastrukturës ligjore dhe asaj fizike, si dhe përmirësimi i ndjeshëm në furnizimet me energji elektrike. Në muajin tetor 2006 treguesi i besueshmërisë së QKZH-së për sektorin e ndërtimit shënon nivelin e minus 8 pikëve. Ky nivel është 2 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë. Nga figura 35 shikohet se niveli aktual i treguesit të besueshmërisë është në nivele më të qëndrueshme sesa ato të konstatuara në dy vitet e fundit, gjë që tregon se ecuria e aktivitetit të ndërtimit në 3 muajorin e katërt të vitit në vazhdim do të jetë në nivel më të lartë se 3 muajorët respektivë për vitet 2004 dhe 2005.

### Niveli i kontraktimeve

Treguesi i mjaftueshmërisë në nivelin e kontraktimeve në muajin tetor 2006 ka shënuar një rritje tjetër me 1 pikë në krahasim me 3 muaj më parë, duke arritur nivelin e -17 pikëve, nivel i cili është 10 pikë më i lartë se një vit më parë. Ky përmirësim në nivelin e kontraktimeve flet për një konsolidim në sektorin e ndërtimit që fillon në 3 muajorin e dytë dhe rritet në nivel më të lartë në 3-mujorin e tretë (shiko figurën 36).


### Parashikimi i punësimit

Indikatori i parashikimit të punësimit për 3 muajt e ardhshëm ka pësuar një rënie prej 5 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë duke arritur në nivelin e 2 pikëve, nivel i cili është gjithashtu 2 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë. Përgjithësisht tendenca në rënie e indikatorit të parashikimit të punësimit në dy 3 muajorët e fundit mund të jetë shkaktuar edhe nga një rritje e shkallës së vetëdeklarimit të të punësuarve në sektorin e ndërtimit, gjë që sjell frenimin për rritjen e punësimit në këtë sektor.

### Aktiviteti i prodhimit në 3 muajt e kaluar


Treguesi i vlerësimit të aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit ka një rritje me 3 pikë në përqindje në krahasim me 3 muaj më parë. Nga figura 38 shikohet se nivelet e këtij treguesi në 2 vrojtimet e fundit të vitit 2006 janë më të ulëta se ato të vërtetuara në vitin 2005, ç'ka tregon për një ulje të ritmeve të rritjes së sektorit të ndërtimit në vitin 2006 në krahasim me dy 3 muajorët respektivë të vitit 2005.

FIGURA 35: Treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit  
CRD confidence indicator in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 36: Vlerësimi i nivelit të kontratave në sektorin e ndërtimit  
Assessment of order-books in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 37: Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit  
Employment expectation in construction sector (next 3 months)



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 38: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit  
Assessment of business activity in the last 3 months in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


**Çmimet në ndërtim**

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e çmimeve të prodhimit në sektorin e ndërtimit në muajin tetor është 43 pikë. Nga figura 39 shihet që tendenca e fortë në rritjen e çmimeve ka filluar që nga tremujori i parë i vitit 2004, duke vazhduar kështu së paku edhe në 3-mujorin e IV të vitit në vazhdim. Arsyet kryesore që çojnë në një tendencë rritjeje të çmimeve në ndërtim mund të shpjgohet me këto dy faktorë: Së pari, në Shqipëri ekzistojnë kushtet optimale për rritje të optimizmit nga ana e konsumatorëve/publikut të cilët tentojnë të rrisin investimet private duke blerë sipërfaqe më të mëdha banimi. Së dyti, tregu i banesave është në nivel pothuajse të pazhvilluar dhe nuk lejon shitblerjen reale të banesave që tashmë janë të ndërtuara në Shqipëri.

**Niveli i kontraktimeve në muaj**


Kontratat e shprehura në muaj pune arrijnë në nivelin e 10 muajve në tetor të vitit 2005, nivel ky që është 1 muaj më i lartë se 3 muaj më parë. Përmirësimi i kontraktimeve të shprehura në muaj është rezultat i konsolidimit të këtij sektori në 3 mujorin e dytë dhe të tretë, e vërtetuar kjo edhe me treguesin e mjaftueshmërisë së nivelit të kontraktimeve.

FIGURA 39: Parashikimi i çmimeve në sektorin e ndërtimit  
*Price expectations in construction sector*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 40: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit  
*Work already contracted in months in construction sector*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**Pengesat në sektorin e ndërtimit  
*Constraints within construction sector***


**Proçedurat për leje ndërtimi**

Lejet e ndërtimit duket se nuk janë "liberalizuar" as në këtë prag fushate të zgjedhjeve vendore. Figura 41 tregon se në muajin tetor 2006, 53 % e të anketuarve shprehen se mungesa e lejeve të ndërtimit është një faktor pengues. Megjithëse ky nivel është relativisht më i ulët se mesatarja historike, se 3 muaj më parë (me 14 pikë në përqindje) dhe një vit më parë (me 3 pikë në përqindje), përsëri ai mbetet faktori numër Një pengues për sektorin e ndërtimit. Siç theksuam edhe më lart mungesa e shesheve të ndërtimit ka një ndikim jo vetëm me ecurinë e volumit të ndërtimeve të reja në ndërtim, por në kushtet e mungesës së një tregu funksional të banesave ndikon në mënyrë të dukshme në rritjen e tendencës së çmimeve në ndërtim.

**Ndikimi i mungesës së kërkesës**


Në muajin tetor 2006, 27 % e të anketuarve shprehen se kanë mungesë të kërkesës konsumatore. Ky nivel është 3 pikë në përqindje më i lartë se 3 muaj më parë dhe rreth 26 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë. Krahasuar me mesataren trevjeçare kjo pengesë është 5 % më e lartë. Ndikimi i mungesës së kërkesës konsumatore mund të çojë në një rritje të presionit mbi ndërtuesit për të zbutur tendencën për rritjen e çmimeve në ndërtim.

FIGURA 41: Ndikimi i proçedurave për leje ndërtimi  
*Building licensing procedures in construction sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 42: Ndikimi i mungesës së kërkesës në sektorin e ndërtimit  
*Insufficient demand in construction sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 42: Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit  
The impact of financial legislation in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 43: Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi në sektorin e ndërtimit  
Unfair competition by black market in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 44: Mos zbatim korrekt i ligjit të prokurimit në sektorin e ndërtimit  
Not correct implementation of the procurement law in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 45: Ndikimi i faktorëve makroekonomikë në sektorin e ndërtimit  
The impact of macroeconomic factors in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

### Legjislacioni fiskal

Përmirësimi i klimës së biznesit në sektorin e ndërtimit duket se ka ardhur edhe nga ulja e ndikimit negativ që ka legjislacioni fiskal për këtë aktivitet. Kështu në muajin tetor 2006 vetëm 23 % e të anketuarve janë të pakënaqur me legjislacionin fiskal në fuqi, kundrejt 52 % që ishin 3 muaj më parë dhe 57 % një vit më parë. Nga figura 42 shikohet, gjithashtu, që ky nivel perceptimi i ndikimit negativ të legjislacionit fiskal në ndërtim, është niveli më i ulët nga të gjitha anketimet e zhvilluara që nga prilli i vitit 2002.

### Konkurrenca nga tregu informal

Në muajin tetor 2006, 23 % e të anketuarve deklarojnë se janë të shqetësuar nga konkurrenca e pandershme e tregut të zi. Ky nivel është 18 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë dhe 25 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë. Sipas të dhënave të anketimit niveli aktual i përgjigjeve mbi këtë pengesë është 22 pikë në përqindje më i ulët se mesatarja 2002-2005. Kjo tregon për ulje të ndjeshme të ndikimit të informalitetit në sektorin e ndërtimit.

### Zbatimi i ligjit të prokurimit

Nga figura 44 shikohet se në muajin tetor, 20% e të anketuarve mendojnë se ligji i prokurimeve publike nuk zbatohet në mënyrë korrekte. Nëse krahasohet me tre muaj më parë përqindja e përgjigjeve të të anketuarve mbi këtë kufizim është vetëm dy pikë më pak ndërsa krahasuar me mesataren 2002-2005 është 13 pikë në përqindje më e ulët. Ky nivel është pothuajse i njëjtë me ato të vërejtura një vit më parë dhe në vitin 2004, gjë që tregon se në këtë 3 muaj pak vëmendje i kushtohet prokurimeve, pasi ky shqetësim është më i dukshëm në muajin prill dhe korrik kur prokurimet edhe pjesa më e madhe e investimeve publike.

### Faktorët makroekonomikë

Në muajin tetor 2006, ndikimi negativ i faktorëve makroekonomikë, si luhatjet e kursit të këmbimit apo inflacioni, është gjithashtu mjaft i limituar. Të shqetësuar ndjehen vetëm 6 % e të anketuarve nga 26 % që ndjeheshin një vit më parë. Nga figura 45 shikohet se ndikimi negativ i këtij faktori ka qenë shumë domethënës në periudhën korrik 2004 - korrik 2005, kur këtë faktor e kanë cilësuar si pengesë 50-60 % e të anketuarve. Niveli aktual në përqindje i ndikimit të faktorëve makroekonomikë ka një rënie të dukshme dhe ndaj mesatares 2002-2005 me 33 përqind.

## **TË PËRGJITHSHME**

Gjatë anketimit të muajit tetor 2006 u kontaktuan rreth 550 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër. nga të cilat u përgjigjën brenda periudhës së anketimit, rreth 500 firma. Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinionëve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuar. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Klima e biznesit vlerësohet nëpërmjet indikatorit të besueshmërisë. Ky indikator për sektorin e industrisë përpunuese llogaritet si mesatare aritmetike e tre indikatorëve: parashikimit të prodhimit, vlerësimin e kontratave të realizuara, dhe vlerësimin e produktit të gatshëm (i marrë me shenjë të kundërt). Për sektorin e ndërtimit indikatorit i besueshmërisë llogaritet si mesatare aritmetike e treguesit mbi vlerësimin e kontraktimeve aktuale dhe parashikimit të punësimit.

### **QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM**

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerja e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar problematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

Drejtoresha Ekzekutive/ *Executive Director*:  
Mirlinda Rusi (Gajo)

Anëtarët e grupit / *Group's members*  
Jonida Naska  
Rozi Poga (Beqiri)  
Bexhet Hyka

Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit.

Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Evropë, një nga institutet më prestigjioze që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është KOF Instituti Zvicerian për Analizën e Ciklit të Biznesit në Zyrih, Zvicër (viti 1955). Stafi teknik i QKZH-së në periudhën 8 -12 qershor 2005 ka marrë pjesë në tavolinat e punës të organizuara nga KOF posaçërisht për rritjen e kapaciteteve teknike të saj në fushat specifike si: hartim metodologjie për përzgjedhjen e kampionit në sektorët e industrisë përpunuese dhe ndërtimit për Shqipërinë; analizë ekonomike për interpretim të rezultateve në lidhje me tendencën e biznesit dhe vlerësimin e indikatorëve sintetike; implementim teknik të tendencave sipas anketimit në bizneset industri përpunuese dhe ndërtim.

### *CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT*

*CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publish research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.*